

## **Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdon punën për ndryshimin e mjedisit**

Përkundër ndryshimeve të mëdha në Kosovë gjatë muajve të fundit, Misioni i OSBE-së vazhdon punën e tij, duke ndihmuar në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut për secilin që jeton atje.

Kosova ka kaluar nëpër ndryshime të mëdha gjatë 18 muajve të fundit. Zgjedhjet e nëntorit të vitit 2007 rezultuan me ndryshimin e qeverisë. Në shkurt të vitit 2008 u shpall pavarësia e njëanshme e Kosovës. Një varg i organizatave të reja ndërkombëtare janë vendosur atje, derisa ato ekzistuese, siç është ajo e UNMIK-ut, kanë shqyrtuar dhe riorganizuar aktivitetet e tyre.

Por, një gjë që nuk ka ndryshuar në Kosovë është roli i Misionit të OSBE-së.

“Sigurisht që ne i jemi përshtatur mjedisit të ri”, thotë kryesuesi i Misionit, Ambasadori Werner Almhofer, “por qëllimi ynë mbetet i njëjtë: ne duam të sigurojmë se respektohen të drejtat e njeriut të të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë”.

Detyra kryesore e misionit është ndërtimi i institucioneve. Fillimisht, kjo nënkuptonte ndihmën për themelimin e institucioneve qendrore dhe kuvendeve komunale, organeve të pavarur si Ombudspersoni si dhe institucioneve themelore të sundimit të ligjit, siç janë policia dhe gjyqësori. Sot, Misioni vazhdon të mbështesë dhe forcojë këto institucione si dhe të monitorojë punën e tyre për përshatshmëri me standardet për të drejtat e njeriut.

“Pavarësisht nga statusi i Kosovës, njerëzit kanë nevojë dhe meritojnë institucione funksionale që ndjekin parimet demokratike dhe që u përmbahen praktikave të qeverisjes së mirë,” thotë Almhofer.

### **Puna e qëndrueshme**

Edhe pse Misioni vazhdon me punën e vet të qëndrueshme, ai i përshtatet rrethanave të reja. Vendosja e Misionit të ri më të madh në Kosovë është ai i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit EULEX.

Dallimi thelbësor në mes të dy misionëve është se EULEX-i punon ngushtë me policinë, gjyqësorin dhe doganat, si dhe ka vendosur gati 1,400 zyrtarë të vet që të punojnë së bashku me policinë e Kosovës. Në ndërkohë, OSBE-ja, vazhdon të monitorojë punën e gjyqësorit, të raportojë për të metat e mundshme dhe të sugjerojë përmirësime, si dhe të sigurojë se puna e policisë së Kosovës është në pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut.

Misioni i kushton vëmendje të veçantë respektimit të drejtave të komuniteteve. Me zvogëlimin e misionit të UNMIK-ut në Kosovë prej 5,000 në 500, roli i OSBE-së në

mbështetje të sigurimit të të drejtave të këtyre komuniteteve është bërë më i rëndësishëm, në veçanti në nivel komunal, pasi që UNMIK-u ka mbyllur pothuajse të gjitha zyrat e tij të terrenit.

### **Prani e fortë në terren**

Sipas drejtorit të qendrës regjionale të OSBE-së në Prishtinë, Bo-Ewert Linne, një suedez me ekperiencë të konsiderueshme në Ballkan, forca e Misionit qëndron pikërisht në strirjen e misionit në terren.

“Gati gjysma e stafit të Misionit prej 800 të punësuarve punon në terren dhe ekipet tona komunale dhe të komunitetit mbajnë kontakte ditore me zyrtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile”, thotë Linne.

Prania e fortë e OSBE-së në terren e bën atë një burim të vlefshëm të informatave për organizatat tjera për ti marrë vendimeve në lidhje me politikën dhe planifikimin e tyre. Për shembull, kur raportuesi për çështjet e Kosovës Björn von Sydow nga Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) kishte nevojë për ndihmë ai erdhi tek misioni i OSBE-s.

“Unë doja të merrja informata nga njerëzë të rëndomtë që të kuptoja se a’i gezojnë të gjithë njerëzit në Kosovë të drejtat dhe liritë e tyre dhe a kanë mundësi të barabarta”, thotë von Sydow.

Meiqë von Sydow ishte në veçanti i interesuar për situatën e sigurisë si dhe për pikëpamjet e komunitetit të serbëve ndaj institucioneve të Kosovës, zyra në terren në Graçanicë, një enklavë e serbëve të Kosovës në dalje të Prishtinës, ishte vendi i duhur për të kuptuar më shumë.

Ekipi i von Sydow-it do t’ia prezentojnë PACE-it të dhënat e tyre në fund të këtij viti. Ai thotë se raporti do të ketë ndikim në vendimet e ardhshme të Këshillit të Evropës për Kosovën.

### **Sytë dhe veshët e komunitetit**

“Ne jemi sytë dhe veshët e komunitetit ndërkombëtarë”, thotë Linne. “Ekipet tona komunale dhe sektorë të specializuar që merren me çështjen e pronës, qeverisjes së mirë dhe komunitetet u ndihmojnë institucioneve lokale ti përmirësojnë shërbimet e tyre, por ato gjithashtu ofrojnë informata edhe për komunitetin ndërkombëtar për t’iu ndihmuar në hartimin e projekteve të tyre mbështetëse”.

Misioni gjithashtu ofron kontributin e tij për vendimarrësit dhe raporton për organizatat tjera ndërkombëtare siç është Komisioni Evropian, që kërkoi të dhëna në lidhje me raportin mbi progresin në Kosovë, të lëshuar në nëntorin e kaluar. Raportet ditore komunale të misionit ndahen me shumicën e akterëve ndërkombëtarë në Kosovë, duke përfshirë edhe NATO-n. Raportet e tij tematike dhe analitike gjithashtu publikohen në mënyrë që të mund të përfitojë çdokush nga to.

“OSBE-ja është e vetmja organizatë ndërkombëtarë civil që ka ruajtur praninë e saj të vazhdueshme në tërë Kosovën për gati dhjetë vite”, thotë Linne. “Organizata perceptohet si një forcë stabiliteti. Ne kemi arritur të vendosim marrëdhënie të mira pune me të gjithë partnerët tanë pasi që ne jemi këtu të këshillojmë dhe ndihmojmë, në linjë me standardet ndërkombëtare,” përfundon ai.